



## Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office

Nr.protokolit 635

Me datën: 22.12.2016

Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 58 të Statutit të Komunës së Rahovecit 01Nr 569/1 i datës 16.12.2010, Kryetari i Komunës, merr këtë :

### V E N D I M

**Për Formimin e Komisionit për pranimin teknik të projektit:  
“NDËRTIMI DHE ASFALTIMI I RRUGËS HADIJE SPAHIU NË QYTETIN E  
RAHOVECIT”, me nr. e Prokurimit 623.16.061.521 dhe nr. të prot. 3125 të dt. 11.10.2016**

- I. Formohet komisioni për pranimin teknik në këtë përbërje :
  1. Sylejman Daka, Kryesues
  2. Beqir Hamza, anëtar
  3. Gzim Makshana, anëtar
- II. Komisioni ka për detyrë që të bëjë pranimin teknik të punimeve sipas kontratës me nr. të prot. 3125 të dt. 11.10.2016.
- III. Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në kontratën ekzistuese të nënshkruar me operatorin.
- IV. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij Vendimit dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit .

*Me Vendim të njoftohen :*

1. Anëtarët e komisionit
2. Drejtorja për Shërbime Publike
3. Zyra e prokurimit
4. Arkivi



**KRYETARI I KOMUNËS**

*Idriz Vehapi*